

Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë ka suspenduar nga puna Irfan Hasan Salihun, imam në xhaminë “Suzi Qelebiu” në Prizren.

Gjithashtu, ndaj të lartpërmendurit është iniciuar edhe masa për Komision Disiplinor, që pritet të mblidhet sapo lënda të kompletohet.

“Sot, Myftiu, Naim ef. Tërnavë, në bazë të nenit 47.1. mbështetur edhe me nenin 45.1 dhe 45.3 të Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, nxori këtë Aktendim me të cilin e suspendon nga puna, Irfan Hasan SALIHUN, imam, hatib dhe mualim në xhaminë ‘Suzi Qelebiu’. Gjithashtu, ndaj të lartpërmendurit është iniciuar edhe masa për Komision Disiplinor, që pritet të mblidhet sapo lënda të kompletohet”, thuhet në komunikatë, raporton Telegrafi.